

Ministrat e Energjisë të rajonit Euro – Mesdhetar njoftuan bashkëpunimin e përforcuar për të sjellë energji të qëndrueshme.

Ministrat e Bashkimit për Mesdheun (UfM) përgjegjës për Energjinë u mbledhën për Konferencën e Tretë Ministrore të Energjisë në Lisbonë më 14 qershor 2021. Konferenca u bashkë-kryesua nga znj. Hala Zaëati, Ministre e Energjisë dhe Burimeve Minerale të Mbretërisë Hashemite të Jordanisë, si dhe znj. Kadri Simson, Komisionere për Energjinë, në Bashkimin Evropian, në prani të z. Nasser Kamel, Sekretarit të Përgjithshëm të Sekretariatit të UfM, dhe nga z. João Pedro Matos Fernandes, Ministër i Mjedisit dhe Veprimit Klimatik të Republikës Portugeze.

Gjatë takimit të bashkëpunimin rajonal drejt sigurisë së energjisë dhe një tranzicioni me emetim me karbon të ulët, Ministrat e Energjisë nga 42 Shtetet Anëtare të UfM miratuan një Deklaratë të re Ministrore, e cila përcakton qëllime ambicioze të energjisë të qëndrueshme që duhen lehtësuar nga integrimi i operimit të sistemeve të energjisë dhe tregjeve në rajonin Euro –Mesdhetar.

Prioritetet kryesore për rajonin e theksuara në Deklaratë përfshijnë: integrimin gradual të sistemeve të operimit të energjisë dhe tregjeve duke garantuar sigurinë e furnizimit të energjisë; përforcimi i interkonjeksioneve të energjisë elektrike dhe rrjeteve inteligjente; një promovim ambicioz i efijencës së energjisë; nevoja për të ndërmarrë veprime të përshtatshme për të tërhequr investime private në burime të ripërtëritshme të qëndrueshme dhe efijente të energjisë; roli i kërkimit dhe zhvillimit, inovacionit dhe dixhitalizimit në mbështetjen e tranzicionit drejt ekonomive dhe shoqërive të drejta, gjithëpërfshirëse, me kosto të ulëta, si dhe me burime të efektshme.

Ministrat shprehën mbështetjen e tyre për tre Platformat e Energjisë UfM, të cilat veprojnë si forume për dialog duke bashkuar palët e interesuara dhe organizatat përkatëse nga i gjithë rajoni. Ata mandatojnë Platformat të përpunojnë plane konkrete veprimi për të zbatuar objektivat e deklaratës. MEDREG është një pjesëmarrës aktiv i tre platformave, përkatësisht Platformës Rajonale të Tregut të Energjisë UfM, Platformës së Energjisë së Rinovueshme dhe Efikasitetit të Energjisë UfM dhe Platformës së Gazit UfM.

Si të tillë, në Deklaratën e tyre Ministrat e Energjisë të rajonit Euro-Mesdhetar pranuan "rolin e rëndësishëm të shoqatave dhe organizatave rajonale të energjisë përfshirë MEDREG", së bashku

me Med-OST, OME, Medener dhe RCREEE, "që mundësojnë një qasje për shkëmbimin e përvojave dhe arritjen e mirëkuptimit të përbashkët drejt harmonizimit të sistemeve energjetike në të gjithë rajonin. ”

Ata shprehin qëllimin politik për të mbështetur më tej masat rregullatore dhe të politikave të nevojshme për të arritur integrimin rajonal të sistemeve të energjisë dhe tregjeve në rajonin e Euro – Mesdheut, për të rritur fleksibilitetin për akomodimin e një shkalle më të lartë të ripërtëritshme të qëndrueshme, për të arritur ekonomi të konsiderueshme të shkallës dhe për të rritur sigurinë të ofertës dhe kërkesës, gjithashtu duke promovuar përf forcimin e interkonjeksioneve të energjisë elektrike në nivelin rajonal dhe EuroMed duke promovuar skema adekuate mbështetëse dhe modernizimin e procedurave administrative në rajonin Euro – Mesdhetar.

Për të tërhequr investime private në burime të ripërtëritshme të qëndrueshme dhe në efiçencën e energjisë, Ministrat mbeshteten krijimin e klimes për një kornizë rregullatore të shëndoshë, të qëndrueshme dhe të parashikueshme.

Për më tepër, ata ftuan palët e interesuara të energjisë në rajon që "të parashikojnë të punojnë së bashku për të forcuar ndërlidhjet rajonale të energjisë elektrike, rrjetet inteligjente dhe dixhitalizimin, për të rritur shkëmbimin e energjisë elektrike, kur është e nevojshme, dhe ndërveprimin, të harmonizojnë rregullat teknike të funksionimit, rregulloren dhe çmimin e energjisë metodologjitë për rrjetin e transmetimit duke marrë parasysh konsideratat/shqetësimet kombëtare. ”

Deklarata gjithashtu rekomandon shkëmbimin e njohurive dhe ndërtimin e kapaciteteve drejtuar institucioneve publike dhe agjencive të energjisë.

Deklarata e tretë Ministrore e UfM për Energjinë – 14 Qershor 2021 është në dispozicion në faqen e internetit të UfM si dhe në linkun e mëposhtëm.

<https://ufmsecretariat.org/wp-content/uploads/2021/06/3rd-UfM-Ministerial-Declaration-on-Energy-14-June-2021-1.pdf>

Presidenti i MEDREG Z.Petrit Ahmeti dhe Z. Elton B. Radheshi (ERE) përfaqësuan MEDREG në këtë konferencë.